

NJOFTIM

Qendra e Personel Rekrutimit do të rekrutojë kandidatë për të ndjekur studimet për “Përgatitjen e Oficerit të Ri” në “Akademinë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” për vitin akademik 2019-2020 për **60 (gjashtëdhjetë)** të drejta studimi.

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është korrik-Shtator 2019.

1. Kriteret e pranimit të kandidatëve:

- Të ketë shtetësi shqiptare.

- Të jetë në moshë jo më shumë se 25 vjeç e 6 muaj, në momentin e aplikimit. Përrjashtim bëjnë kandidatët për oficerë, të cilët do të jenë personel mjekësor i Forcave të Armatosura dhe duhet të mos jenë më shumë se 30 vjeç e 6 muaj në momentin e aplikimit.

- Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë brenda dhe jashtë vendit.

- Të zotërojë diplomën e arsimit të lartë (minimumi “Bachelor”) brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe të ekuivalentuar nga ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë.

- Të ketë notë mesatare të lëndëve të të gjitha viteve të arsimit të lartë, jo më pak se 6 (gjashtë).

- Të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor nga Njësia Mjekësore Ushtarake e Forcave të Armatosura.

- Të ketë gjatësi trupore jo më pak se 170 cm për meshkujt dhe jo më pak se 165 cm për femrat.

- Të mos jetë i larguar nga puna në administratën qendrore ose lokale (nëse ka qenë i punësuar para aplikimit), për shkelje të dispozitave të kodit të punës ose legjislacionit në fuqi. Kjo kërkesë aplikohet për kandidatët që nuk janë pjesë e FA.

- Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm nga të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformatojnë pamjen.

- Të mos jetë bartës i virusit HIV, hepatitit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme), të mos ketë kaluar apo të vuajë nga sëmundje të zemrës, veshkave, hepatike, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemi lokomotor (sistemit kockor dhe të lëvizjes) apo të ketë qenë dhe të jetë përdorues i lëndëve narkotike.

- Ky burim është i hapur dhe për ushtarët/detarët dhe nënoficerët aktivë të FA, të cilët përveç kriterëve të mësipërme, duhet të plotësojnë edhe kriteret si më poshtë:
 - a) të ketë vlerësimin e fundit të punës jo më pak se “shumë mirë”
 - b) të mos ketë asnjë masë disiplinore në fuqi
 - c) bashkë me dokumentet e aplikimit të paraqesin një rekomandim nga Komanda ku shërbejnë, në të cilin konfirmohet pjesëmarrja e tyre në konkurim si dhe cilësitë e tyre.

Kandidati që nuk plotëson qoftë dhe një nga kriteret e përmendura më sipër, s`kualifikohet.

2. Dokumentet për regjistrim

Kandidatët për regjistrim duhet të paraqesin pranë Zyrës së Pranimit, Tiranë, dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati për ndjekjen e studimeve ushtarake në Akademinë e Forcave të Armatosura, në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes.
- Formular me të dhëna personale sipas formatit të përcaktuar, **ANEX A**
- Fotokopje e noterizuar e diplomës që vërteton përfundimin e arsimit të lartë së bashku me listën e notave të lëndëve.
- Fotokopje e kartës së identitetit.
- Fotografi për dokument (4x6), 2 (dy) copë
- Raportin mjekësor të lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor (KML) i Qendrës Shëndetësore të vendbanimit dhe grupin e gjakut.
- Analizat e gjakut për Hepatitin B dhe C, HIV/AIDS dhe grupin e gjakut të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut ose banka e Gjakut apo Drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethet ku banojnë.
- Formular i vetëdeklarimit për gjendjen shëndetësore, i cili plotësohet pranë Qendrës së Personel Rekrutimit në momentin e dorëzimit të dokumentacionit.

Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët e kualifikuar pas përfundimit të testimit:

- Dëshmi penaliteti.
- Vërtetim nga gjykata që nuk është në proces gjyqësor
- Vërtetim nga prokuroria që nuk është në proces hetimi
- Vërtetim nga përmbarimi
- Raportin mjekësor të lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor (KML) i Njësisë Mjekësore Ushtarake.

3. Testimet që do të zhvillohen:

**Testi Fizik,
Testi i Gjuhës së Huaj (Anglisht),
Testi Intelektual,
Testi Psikologjik.**

Për më tepër informacion kontaktoni në nr. : 0682722490

**DEGA E REKRUTIM-MOBILIZIMIT
KORÇË**